



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:266205

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05840415

K.DH.SH.II.nr.859/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Auloni” Shpk me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ymer Bardhi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.358/2022 të datës 29.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.06.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit “Auloni” Shpk me seli në Prishtinë e datës 02.04.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.358/2022 të datës 29.02.2024, **Vërtetohet**.

## Arsyetim

Dhoma e Shkallës së Parë me aktgjykimin e ankimuar KF.nr.358/2022 të datës 29.02.2024, në pikën I të dispozitivit, Refuzohet kërkesë padia e paditësit Auloni ShPK me seli në Prishtinë si

e pa bazuar, nën pikën II. Mbetet në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/18259; 21563 i datës 22.11.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. Nën pikën III, Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja ti kthehet Dhomave të Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo aktgjykimi i apeluar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e pa bazuar dhe autorizimi VH032 për importim mallrash nën regjimin pezullues IM7 të mbetet edhe më tej në fuqi dhe kështu paditësit ti lejohet si deri me tani zhdoganimi në procedurë të rregullt të mallrave të importuara nën regjimin IM7.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa është e pa-bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr.01.3.2.2/18259, 21563 është aprovuar kërkesa e subjektit në procedurë “Auloni” Shpk –Prishtinë për rishqyrtimin e aktvendimit numër 04.1.5/17296 datë 10.09.2021 të lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve. Nën pikën II. Anullohet aktvendimi numër 04.1.5/17296 datë 10.09.2021 të lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe i Autorizimeve, lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve me të gjitha shkresat e lëndës.

Dhoma e Shkallës së Parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin KF.nr.358/2022 të datës 29.02.2024 e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit) duke lënë në fuqi vendimin kontestues të paditurës. Në arsyetim të aktgjykimit ndër tjerash ka cek se nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, del se e paditura Dogana e Kosovës ka analizuar dokumentet e bashkangjitura dhe ka ardhur në përfundim se vendimi i ankimuar ka të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit kontestues, të meta të tilla të cilat konsistojnë në faktin se arsyetimi vendimit kontestues përmban të dhëna të pa mjaftueshme dhe jo të plota sa i përket revokimit të autorizimit për drejtim të procedurës së magazinimit doganor, duke mos vlerësuar drejtë faktet në raport me përcaktimet ligjore. Kështu e paditura në shkallë të dytë ka konstatuar se ndaj subjektit këtu paditësit nuk është nxjerr asnjë akt në procedurë kundërvajtëse doganore me të cilën subjekti do të konstatohej shkelja dhe i njëjti do të shpallej përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga dispozita e nenit 276, pika m), e KDA-së. Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë kontest tregtar administrativ Gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e tija mbi bazën e të cilave lënda nuk do të duhet të kthehej nga vet e paditura tek organi i shkallës së parë për evitimin e të metave të theksuara si në Aktvendimin kontestues. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 01.3.2.2/18259; 21563 i datës 05.07.2021, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i ankimuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), e as me nenin 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as nga neni 38 të LKA -së, po ashtu nuk është i

përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Si rezultat i kësaj, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se dokumentacioni në formën e faturave dhe dokumentacioni tjetër përkatës ka arritur së bashku me mallin dhe të njëjtat si të tilla edhe janë dorëzuar tek Zyra Doganore në Jarinjë, Leposavicë, paditësi si importues nuk ka qenë paraprakisht e njoftuar se agjenti i saj doganor z. Artan Uka në harresë dhe pa qëllime ka bërë shkelje ligji dhe kështu edhe përfitimi material në kundërshtim me ligjin në dokumentacionin Transit (T1), pasi që e paditura me aktin administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë ka provuar kërkesën e paditësit ka anuluar aktvendimin 04.1.5/17296 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Sektori i Procedurave dhe i Autorizimeve me të gjitha shkresat e lëndës, andaj, kolegji ka vlerësuar se në këtë fazë nuk mund të bëhet vlerësimi i provave pa pasur një vendim meritore nga ana e të paditurës Dogana e Kosovës, dhe se paditësi në këtë fazë të shqyrtimit nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e tij mbi bazën e të cilave lënda nuk do të duhej të kthehej nga vet e paditura tek organi i shkallës së parë për shkak të dhënave të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket revokimit të autorizimit për drejtim të procedurës së magazinimit doganor. Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si

dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.859/24, me datë 20.06.2024

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri